




UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE MJEDISIT
Departamenti i Prodhimit Shtazor

MIRATOHET

DEKANI



Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU

**Udhëzim për përgatitjen dhe procedurat e
mbrojtjes së mikrotezës**

për studentët që diplomohen në
programin e studimit Master Shkencor "Zootekni"

Përgjegjësi i Departamentit

Prof. Dr. Anila HODA

Tiranë Maj 2017

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Baza ligjore	1
Qëllimi i udhëzuesit	1
Të dhëna të përgjithshme	1
Përzgjedhja e fushës, si dhe e udhëheqësit.....	1
Përgatitja e mikrotezës	2
Mbrojtja e tezës	2
Struktura dhe formati i paraqitjes së mikrotezës.....	2
Struktura.....	2
Kërkesë për përcaktimin e Fushës së Temës së Tezë së MSc.....	5
Deklaratë bashkëpunimi për realizimin e tezës së Masterit Shkencor	6

BAZA LIGJORE

Ky udhëzues mbështetet në

- Ligjin Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë
- Statutin e Universitetit Bujqësor të Tiranës
- Rregulloren e Studimeve Universitare të UBT
- Rregulloren e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit

QËLLIMI I UDHËZUESIT

Ky udhëzues aplikohet për programin e studimit Master Shkencor, "Zootekn", i cili mundëson marrjen e gradës "Master i Shkencave". Udhëzuesi ka të bëjë me përzgjedhjen e temës, detyrat dhe përgjegjësitë, si dhe mbrojtjen e tezës.

TË DHËNA TË PËRGJITSHME

Studenti në fund të ciklit të studimeve "Master Shkencor" ka të drejtën të diplomohet dhe të marrë gradën përkatëse, nëse i ka fituar të gjitha kreditet e parashikuara në programin mësimor.

Diplomimi bëhet në dy sezona të veçanta të verës dhe sipas afateve të paracaktuara nga Dekani.

Kandidati i cili nuk arrin të mbrojë tezën e diplomës, ose rrëzohet në mbrojtje në sezonin e verës, ka të drejtë ta japë atë në sezonin tjetër.

Dekani miraton komisionin e provimit të formimit, bazuar në propozimin e përcjellë nga Përgjegjisi i Departamentit. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë me titull "Profesor" ose "Profesor i asociuar".

PËRZGJEDHJA E FUSHËS, SI DHE E UDHËHEQËSIT

Departamenti semestrin e dytë, informon studentët për fushat e kërkimit dhe studenti mund të përzgjedhë udhëheqësin sipas preferencave. Të drejtën për të udhëhequr studentët e "Masterit Shkencor" e kanë të gjithë anëtarët e stafit akademik që kanë së paku gradën shkencore "Doktor".

Departamenti në një mbledhje të veçantë miraton udhëheqësin dhe fushën përkatëse për çdo student të Masterit Shkencor.

Studenti së bashku, me miratimin e profesorit udhëheqës përgatit projektin e diplomës. Studenti informohet për modalitetet e përgatitjes dhe vlerësimit të tezës së diplomës. Studenti duhet të përfundojë të gjitha modulet, pjesë e programit.

PËRGATITJA E MIKROTEZËS

Gjatë semestrit të katërt, të programit "Master i Shkencave" përveç praktikës profesionale, studenti në bashkëpunim me udhëheqësin dhe në kontakt të vazhduar me Departamentit, realizon hap pas hapi tezën e diplomës dhe përgatitet për të bërë prezantimin final të punës. Teza e shkruar e diplomës duhet të hartohet dhe përgatitet sipas modelit të përcaktuar në këtë udhëzues. Për çdo problem, paqartësi, studenti dhe udhëheqësi i drejtohen Përgjegjësit të Departamentit.

Pas përfundimit të përgatitjes së tezës, studenti dhe udhëheqësi i tij, konfirmojnë punën e kryer dhe dorëzojnë dy kopje të tezës, sipas afatit të përcaktuar më poshtë. Gjithashtu studenti depoziton në formë elektronike, format të pamaniplueshëm punimin e tezës, pranë sekretarisë së Departamentit.

Studenti del në mbrojtje të tezës, pasi ka përmbytur të gjitha detyrimet akademike, sipas programit mësimor, por edhe detyrimet financiare ndaj Institucionit.

MBROJTJA E TEZËS

Mbrojtja e tezës është një procedurë e hapur. Teza diplomës depozitohet në departament të paktën 2 javë para datë së mbrojtjes. Sekretaria mësimore përgatit listën e studentëve të cilët do të dalin në mbrojtjen e diplomës. Studenti gjithashtu duhet të ketë likuaduar të gjitha detyrimet financiare me universitetin .

Mbrojtja e tezës organizohet sipas kësaj procedure:

- Studenti prezanton para komisionit tezën e tij
- Komisioni i drejton pyetje rreth tezës, dhe studenti përgjigjet
- Komisioni mblidhet dhe të gjithë anëtarët japin vlerësimin me pikë (notë)
- Kryetari i komisionit, që përgjithësisht është Përgjegjësi i Departamentit jep vendimin e studentit të diplomuar.

STRUKTURA DHE FORMATI I PARAQITJES SË MIKROTEZËS

Struktura

- Teza e Masterit Shkencor duhet të përbëhet nga rreth 40 - 50 faqe A4, të shtypura nga një anë me madhësinë e gërmave 12, tipi shkrimit Times New Roman dhe distanca midis rreshtave, së paku 15;
- Kopetina e tezës duhet të jetë prej kartoni. Në krye vendoset Logo e Universitetit Bujqësor të Tiranës, si dhe poshtë saj shkruhet Emri i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit dhe Departamentit të Prodhimit Shtazor. Gjithashtu, në kopertinë vendoset titulli i temës, emri i studentit, i udhëheqësit shkencor, si dhe muaji dhe viti i mbrojtjes;
- Faqja e parë e brendshme e tezës është e njejtë me kopertinë;
- Në faqen e dytë shkruhet “**Dedikim**”, i cili është fakultativ;

- Në faqen e tretë shkruhet “**Mirënjohje/falenderim**”, e cila është gjithashtu fakultative;
- Në faqen e katërt jepet “**Përmbajtja e lëndës**” e cila duhet të jetë e detajuar: kapitujt, titujt dhe nëntitujt e çdo kapitulli dhe numri përkatës i faqeve. Në vijim jepet “**Lista e tabelave**” dhe “**Lista e figurave**” e shoqëruar me numrat përkatës të faqeve;
- Më pas vazhdohet me kapitujt e tezës: “**Hyrja**”, “**Materiali dhe Metoda**”, “**Rezultatet**”, “**Diskutimet**” (ose “**Rezultatet dhe Diskutimet**”), “**Konkluzione**”, “**Përmbledhje**”, “**Summary**” (në anglisht 2-5 faqe), “**Literatura**”, “**Aneks**” (fakultative). Çdo kapitull ka çështjet dhe nënçështjet e veta;
- **Lloji i shkrimit** sipas niveleve:
 - 1 **Titulli kryesor** ose Titulli i kapitullit: Times New Roman; Bold; 16, all capital; hanging 0.3; hapësira para dhe pas tij 12;
 - 1.1 **Niveli i parë**: Times New Roman; Bold; 14; Small capital, hanging 0.4; hapësira para dhe pas tij 6;
 - 1.1.1 **Niveli i dytë**: Times New Roman; Bold; 14; hanging 0.5; hapësira para dhe pas tij 6;
 - 1.1.1.1 **Niveli i tretë**: Times New Roman; Bold dhe italic; 14; hanging 0.6; hapësira para dhe pas tij 6;
- Faqet e tezës duhet të formatohen si vijon
- **Margjinat** për të gjithë tekstin do të jenë:
 - Margjina e sipërme 1”
 - Margjina e poshtme 1”
 - Margjina e majtë 1.25”
 - Margjina e djathtë 1.25”
- Të gjithë **numrat e faqeve** duhet të vendosen poshtë dhe në mes të faqes;
- **Shënimet** duhen të bëhen me shkrim Times New Roman, 12, hapësira *single*;
- **Tabelat** të përfshihen në tekst. Tabelat duhet të vendosen në qendër të faqes, brenda margjinave të caktuara. Çdo tabelë i duhet vendosur një numër referimi që duhet të ndjekë numrin e kapitullit të cilit i përket. Fjala “Tabela”, numri i tabelës dhe legjenda duhet të vendosen në krye të tabelës. Shkrimi duhet të jetë Times New Roman, 12, bold. Nëse tabela vazhdon në faqen tjetër legjenda nuk përsëritet. Nëse një tabelë përmban citate referencat duhet të theksohen;
- **Ilustrimet dhe diagramat** duhet të skanohen dhe të inkorporohen në versionin elektronik të dokumentit. Fjala “Figura”, numri i diagramës që ndjek numrin e kapitullit të cilit i përket dhe legjenda të vendosen poshtë diagramës apo figurës. Shkrimi duhet të jetë Times New Roman, 12, bold;
- **Literatura** e cituar në tekst do të jetë me mbiemër të autorit dhe të tjerë (Brayan *et al*, 2006); Formatimi i Referencave (Literatura)
 - Shkrimi në fund të tezës, i punimeve të cituar,:

- Kliem H, Berisha B, Meyer H, Schams D: **Regulatory changes of apoptotic factors in the bovine corpus luteum after induced luteolysis.** *Molecular Reproduction and Development* 2009, **76**(3): 220-230.
- Lodish HF, Berk A: **Molecular cell biology:** WH Freeman; 2008.
- Griffiths AJ: **DNA: Structure and replication.** In: *Introduction to genetic analysis:* WH Freeman; 2005: 920-940.
- Yetim H: **Biochemical and structural alteration of restructured fish muscle as influenced by egg white tumbling and storage time.** PhD Dissertation. The Ohio State University, Columbus, Ohio, USA. 1993.
- Podgrabinska S, Braun P, Velasco P, Kloos B, Pepper MS, Jackson DG, Skobe M: **Molecular characterization of lymphatic endothelial cells.** *Proceedings of the National Academy of Sciences of the United States of America* 2002, **99**(25): 16069.



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE MJEDISIT
Departamenti i Prodhimit Shtazor

Tiranë, më

Kërkesë për përcaktimin e Fushës së Temës së Tezës së MSc

Studenti _____

Programi studimor Master i Shkencave, "Zootekni" parashikon diplomimin e studentëve me temë diplome, e cila së bashku me Praktikën Profesionale përfshin 30 ECTS.

Studenti ka të drejtë të propozojë fushën, si dhe udhëheqësin shkencor me të cilin dëshiron të kryejë punimin e tezës. Studenti ka të drejtë të propozojë deri në dy fusha.

Departamenti mbi bazën e sugjerimeve/kërkesave të studentëve, si dhe kapaciteteve që ka, vendos shpërndarjen e studentëve sipas fushës dhe udhëheqësit.

Studenti pas miratimit të fushës dhe udhëheqësit, vijon të mbajë kontakte me udhëheqësin shkencor.

Nr.	Fusha	Udhëheqësi
1.		
2.		
3.		

Studenti

Emër Mbiemër



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE MJEDISIT
Departamenti i Prodhimit Shtazor

Tiranë më

Deklaratë bashkëpunimi për realizimin e tezës së Masterit Shkencor

Pedagogu _____, pranon të jetë udhëheqës shkencor i studentit
_____, në fushën _____

Studenti

Pedagogu

Emri Mbiemri

Emri Mbiemri